

STATUT
I
SHOQËRISË

CCP-GROUP SHPK

Neni 1 – Emërtimi dhe shoqëria

- 1.1 Emërtimi i shoqërisë është CCP-GROUP SHPK, më poshtë e quajtur “Shoqëria”.
- 1.2 Shoqëria është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

Neni 2 - Personaliteti juridik

- 2.1 Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Neni 3 - Selia

- 3.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: Rruga e Kavajës, qendra CONDOR, Njësia 40, Tiranë, Shqipëri.
- 3.2 Shoqëria mund të hapë dhe mbajë zyra dhe/ose të kryejë aktivitete në vende të tjera, brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë si dhe të hapë ose mbyllë zyra në vende të ndryshme përveç selisë së Shoqërisë.

Neni 4 - Kohëzgjatja

- 4.1 Kohëzgjatja e Shoqërisë është për një periudhë kohore të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Neni 5 - Objekti

- 5.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin si më poshtë vijon:
Projektim, arkitekturë, konstruksion, zbatim i tyre. Ndërtime civile dhe ekonomike. Ndërtime industriale, turistike, bujqësore, etj., mbi 2 kate dhe kompletim me instalimet e nevojshme për to. Studim, projektim, financim, menaxhim, administrim i ndërtimeve civile, ekonomike, socialkulturore, ushtarake, portuale, shtëpi banimi, infrastrukturë, rrugë, ura, parqe industriale etj. Ndërtime vepra arti rrugore dhe hekurudhore. Ndërtime detare dhe hidroteknike. Punime restaurimi, rikostruksione godinash civile dhe ekonomike etj. Prodhim dhe tregtim, import eksport mobiljesh, të lëndëve të drurit. Shoqëria mund të zhvillojë gjithashtu çdo aktivitet tjetër plotësues e ndihmës që rezulton i dobishëm dhe/ose i nevojshëm për përmbushjen e objektit kryesor, duke përfshirë tregtimin e produkteve dhe kryerjen e shërbimeve të tjera. Me qëllim realizimin e objektit të saj, me vendim të organit vendimmarrës, Shoqëria mund të zotërojë në mënyrë direkte apo indirekte, aksione apo pjesëmarrje në shoqëri të tjera shqiptare dhe/ose të huaja. Shoqëria, me vendim të organit vendimmarrës, me qëllim realizimin e objektit të saj, mund të marrë pjesë në çfarëdo lloj marrëveshje tregtare dhe/ose joint venture me shoqëri të tjera e sipërmarrje, si edhe të kryejë çdo akt tjetër të nevojshëm. Shoqëria, me vendim të organit vendimmarrës, mund të lidhë kontrata qiraje, shitblerje, marrëveshje për vendosje hipoteke mbi pasuri të paluajtshme, marrëveshje huadhënie apo financimi, marrëveshje për ofrimin e shërbimeve dhe çdo marrëveshje tjetër që konsideron të nevojshme për përmbushjen e objektit të saj. Import eksport dhe tregtim me shumicë dhe pakicë të rrobave të gatshme, tekstile, metrazhe etj. Import - eksport i aparaturave imazherike dhe aksesoreve të tyre, aparatatura dentare dhe aksesore, aparatatura laboratorike si dhe hapjet e depove farmaceutike, ofrimi i shërbimeve ndërhyrëse higjeno-sanitare si dezinfektim dhe procese të tjera.

5.2 Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër biznesi i cili nuk është i ndaluar nga ligji i zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë.

Neni 6 - Kapitali i Shoqërisë

- 6.1 Kapitali i Shoqërisë është në vlerën 2,000,000.00 (dy milion) Lekë, i ndarë në 1 (një) kuotë me vlerë nominale prej 2,000,000.00 (dy milion) Lekë, e cila përfaqëson 100 % (njëqind për qind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.
- 6.2 Kapitali i Shoqërisë është tërësisht i nënshkruar dhe i pagueshëm nëpërmjet kontributeve në para si dhe zotërohet plotësisht nga Ortaku i Vetëm Z. Avenir Boshnjaku, shtetas shqiptar, lindur në Shkodër, më 08.11.1978, mbajtës i letërnjoftimit nr. 037238258, me adresë në: Rr. Petro Nini Luarasi Tiranë, Pallati 10/1, Shk. 2, Ap.14, Tiranë, Shqipëri, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar.

Neni 7 - Zmadhimi i kapitalit

- 7.1 Zmadhimi i kapitalit bëhet me vendim të Ortakut të Vetëm.
- 7.2 Zmadhimi i kapitalit mund të bëhet me derdhje në para ose me kontribute në natyrë. Në çdo rast shlyerja e kapitalit nëpërmjet kontributeve në natyrë duhet të shoqërohet me një raport vlerësimi për shprehjen e vlerës së kontributit në para, i cili duhet të kryhet nga një ekspert vlerësues i kontributeve në natyrë.

Neni 8 - Zvogëlimi i kapitalit

- 8.1 Zvogëlimi i kapitalit bëhet me vendim të Ortakut të Vetëm me propozim të Administratorit (ëve), në rastin kur Shoqëria mund të pësojë humbje të tilla që ta bëjnë të domosdoshëm këtë zvogëlim.

Neni 9 - Transferimi i kuotës

- 9.1 Kuota ose çdo pjesë e saj mund të transferohet lirisht palëve të treta me vendim të Ortakut të Vetëm në çdo kohë nëpërmjet shitjes, trashëgimisë, dhurimit ose me çdo mënyrë tjetër të parashikuar nga ligji dhe ky-statut.

Neni 10 - Kompetencat e Ortakut të Vetëm

10.1 Ortaku i Vetëm, në përputhje me legjislacionin shqiptar, mund të marrë, por pa u kufizuar vetëm në to, vendime për ndryshimin e Statutit, bashkimin me shoqëri të tjera, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit, transferimin e plotë ose të pjesshëm të kuotave, emërimin dhe shkarkimin e administratorit (ëve), emërimin e ekspertit kontabël, miratimin e llogarive vjetore dhe të pasqyrave financiare, likuidimin e Shoqërisë, emërimin e likuidatorit(ëve).

10.2 Të gjitha vendimet e marra nga Ortaku i Vetëm do të regjistrohen sipas rendit kronologjik në Regjistrin e Vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose fshihen. Vendimet e paregjistruara në këtë regjistër janë të pavlefshme. Administratori/ët e Shoqërisë janë përgjegjës për mbajtjen e Regjistrit të Vendimeve.

Neni 11 – Administratori/ët

- 11.1 Administratori/ët e parë të Shoqërisë janë:



a. Z. Avenir Boshnjaku, shtetas shqiptar, lindur në Shkodër më 08.11.1978, mbajtës i letërnjoftimit nr.037238258, dhe me numer personal H81108086M me adresë në: Rr. Petro Nini Luarasi Tiranë, Pallati 10/1, Shk. 2, Ap.14, Tiranë, Shqipëri.

11.2 Administratori/ët emërohet me vendim të Ortakut të Vetëm dhe do të qëndrojë në detyrë për një afat 5 (pesë) vjeçar. Administratorët/ët mund të rizgjidhen për të njëjtin afat në bazë të vendimit të Ortakut të Vetëm ose siç parashikohet në dispozitat ligjore.

11.3 Në rast të dy ose më shumë Administratorëve, Ortaku i Vetëm mund të marrë vendim për përcaktimin e zbatimit dhe kryerjes së kompetencave dhe detyrave nga një ose disa prej administratorëve, veç e veç ose së bashku.

11.4 Administratorët mund të shkarkohen nga detyra në çdo kohë me vendim të Ortakut të Vetëm.

Neni 12 - Kompetencat e Administratorit/ëve

12.1 Administratori/ët është përgjegjës për çështjet e përditshme të Shoqërisë dhe përfaqëson Shoqërinë në marrëdhënie me të tretët në përputhje me dispozitat e Statutit dhe/ose ligjit të zbatueshëm.

12.2 Shoqëria administrohet nga një administrator, i emëruar nga Ortaku i Vetëm. Veprimet në emër të Shoqërisë kërkojnë nënshkrimin e të paktën 1 (një) prej Administratorëve.

12.3 Të drejtat dhe kompetencat e administratorit/ëve, nëse nuk parashikohet ndryshe me vendim të Ortakut të Vetëm, do të jenë si më poshtë:

- a) të mbikëqyrë/in dhe zbatojë/në politikat e biznesit të Shoqërisë;
- b) të sigurohet/n që shoqëria zbaton ligjet dhe standardet e mbajtjes së llogarive;
- c) të shqyrtojë/në dhe mbajë/në Librat e Shoqërisë, Regjistrin e Vendimeve, dokumentet dhe aktivet;
- d) të sigurojë/në që deklarata e llogarive vjetore si dhe raporti i ecurisë së biznesit dhe çdo deklaram tjetër i detyrueshëm sipas ligjit të zbatueshëm ose statutit janë kryer siç duhet;
- e) me kërkesë me shkrim të Ortakut të Vetëm, të marrë/in masa të cilat janë në kompetencë të këtij të fundit; të rekomandojë/në vendime për tu miratuar nga Ortaku i Vetëm dhe t'i zbatojë/në këto vendime;
- f) Z. Avenir Boshnjaku, në cilësinë e tij si administrator i Shoqërisë, të hapë llogari bankare, në EUR dhe Lekë pranë të gjithë ose secilës prej bankave të nivelit të dytë në Shqipëri, sipas gjykimit të tij, në emër e për llogari të shoqërisë, si dhe të ndërmarrë, zbatojë dhe nënshkruajë të gjithë aktet dhe veprimet e nevojshme për këtë qëllim pranë bankave përkatëse, si dhe çdo veprim tjetër të nevojshëm për tu kryer gjatë aktivitetit të shoqërisë kundrejt bankave, përfshirë kryerjen e transaksioneve bankare; si dhe
- g) të ndërmarrë/in çdo detyrë tjetër të caktuar nga ligji ose statuti.

Neni 13 - Viti ushtrimor financiar

13.1 Viti ushtrimor financiar fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe përfundon më 31 Dhjetor 2023.

Neni 14 - Prishja dhe shpërndarja

14.1 Për prishjen dhe shpërndarjen e Shoqërisë, në çdo kohë dhe për çfarëdolloj arsye, si dhe për likuidimin dhe për emërimin e likuidatorëve, do të vendoset sipas dispozitave të ligjit shqiptar në fuqi.

Neni 15 - Baza ligjore

15.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Statut dhe me legjislacionin shqiptar.

15.2 Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut, do të aplikohen normat e legjislacionit shqiptar në fushën e shoqërive tregtare dhe në veçanti të ligjit “Për tregtarë dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.

15.3 Çdo konflikt që mund të lindë në lidhje me zbatimin dhe interpretimin e këtij Statuti, si dhe çdo konflikt që mund të lind midis Shoqërisë dhe të tretëve, në rastet e përgjegjshmërisë, dhe raste të tjera, do të jetë objekt i zgjidhjes nëpërmjet vendimit të gjykatave shqiptare.

Neni 16 - Ndryshimet

16.1 Ky Statut mund të ndryshohet, rishikohet dhe/ose shfuqizohet pjesërisht ose i tëri dhe të zëvendësohet me një statut të ri me vendim të Ortakut të Vetëm.

16.2 Ky Statut është hartuar në 2 (dy) kopje në gjuhën shqipe, me vlerë të njëjtë secila.

Nënshkruar, sot më datë 07 Nëntor 2023.

Ortaku i Vetëm

Z. Avenir Boshnjaku

Avenir Boshnjaku

